

VENDIM
Nr.742, datë 8.9.2010

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS DRENOVË TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Drenovë të qarkut të Korçës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 88 (tetëdhjetë e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 534 (pesëqind e tridhjetë e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Drenovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Drenovë

Lidhja nr.1

NUMRAT RENDORË TË PRONAVE NË LISTËN E INVENTARIT	FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS	LLOJI I TRANSFERIMIT
71-78	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE ARSIMORE.	NË PRONËSI
87,95-100	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË SHËNDËTIN PUBLIK.	NË PRONËSI
79-86,88,89,523-526	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE SOCIAL-KULTURORE E SPORTIVE.	NË PRONËSI
102-110	VARREZAT PUBLIKE	NË PRONËSI
111-118 (VETËM TROJET)	TROJE TË LIRA DHE HAPËSIRA PUBLIKE TË PAZËNA NDËRMJET NDËRTESAVE DHE OBJEKTEVE TË ÇDO LLOJI	NË PËRDORIM
111-118 (VETËM SHESHET) 361,362,365,366	INFRASTRUKTURË (SHESHE, RRUGË VENDORE, LULISHTË DHE SHËRBIME PUBLIKE)	NË PRONËSI
1-3,5,7,8,12-70,520-522	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA PRODUKTIVE).	NË PËRDORIM
4,6,9-11,345,349,353,355, 358, 360	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (KANALE TË TRETË DHE TOKA JOPRODUKTIVE).	NË PRONËSI
451-457	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE.	NË PRONËSI
500-519	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E STREHIMIT DHE MBROJTJES CIVILE.	NË PRONËSI
528-534	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E PYJE & KULLOTA.	NË PRONËSI